



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 9, datë 18.01.2024

PËR

**CAKTIMIN E RELATORIT NË PROCEDURAT E VERIFIKIMIT TË KANCELARIT
NË DETYRË DHE KANDIDATËVE PËR NË PROGRAMIN E FORMIMIT
FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR NDIHMËS LIGJORË,
TË PAPËRFUNDUARA PËR SHKAK TË MBARIMIT TË MANDATIT TË
ANËTAREVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR ZNJ. {...}DHE ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90 dhe 97, pika 1 shkronja “a”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 55 dhe 83, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424 , datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, nr.496, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”; nr. 473, datë 07.09.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2023-2024”; vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 736 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}” dhe nr. 737, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Caktimin e znj. {...} relatores të procedurës së verifikimit të kancelarit në detyrë, të papërfunduar për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë:
 - i. Leonard Strataj.
2. Caktimin e znj. {...} relatores të procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, në vitin akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, si më poshtë:

- i. znj. {...};
- ii. znj. {...};
- iii. z. {...}.

- 3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kancelarit në detyrë dhe kandidatëve për ndihmës ligjorë sipas pikës 65 të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR